



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror
Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja Nr. 40
Prishtinë, më 14.09.2010, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Sanije Aliaj, Müfera Şinik, Rexhep Hoti, Numan Balić, Hafize Hajdini, Xhevdet Neziraj, Dragiša Mirić, Enis Kervan, Hetem Arifi dhe Mursel Haljilji.

Munguan: Petar Miletić, Sadik Idriz dhe Zylfi Merxha.

Në mbledhje prezantuan: përfaqësuesi nga OSB-ja Elita Vokshi, përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Nga Stafi Mbështetës: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Sanije Aliaj, Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Takim me ministrin e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim

Kryesuesja-konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me këtë pikë të rendit të ditës.

1. Takim me ministrin e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim

Sanije Aliaj- e njoftoi Komisionin që para se të arrijë në mbledhje ka marrë një telefonat nga zëvendësministri i KK, i cili ka informuar se për arsye shëndetësore ministri nuk do marrë pjesë në takim. Ajo dha sqarim se ka kërkuar nga ai që të jetë prezent në këtë takim ndërsa përgjigjja ka qenë që lidhur me ftesën, përgjegjësia i takon MPMS.

Ajo kërkoi që Ministria e KK të jetë më përgjegjëse ndaj komisionit dhe se sipas planit të Veprimt, dhe se çështjet e caktuara në komision të mos neglizhohen.

Ajo propozoi që në javën e ardhshme të përsëritet ftesa e Ministrit të KK, i cili duhet të ofroi opinionet e tija lidhur me çështjet e projektit për ndërtimin e 44 shtëpive në Kuvendin Komunal në Ferizaj –fshati Dubravë si dhe të ofrojë të dhëna në realizimin e projekteve për vitin 2010. Gjithashtu propozoi që Komisioni në fund të muajit shtator të vizitoi komunën e Fushë Kosovës, me qëllim të njohjes me realitetin jetësor të komuniteteve.

Numan Balić – mendon që mospjesëmarrja e ministrit në takim të procedohet në Kryesi. Më pas tha se duhet të përsëritet ftesa Ministrit dhe njëherit u pajtua që Komisioni të vizitoi Kuvendin komunal në Fushë Kosovë.

Xhevdet Neziri – me theks të veçantë tha se ministri duhet të informoi komisionin për projektin e Dubravës, si dhe për të arriturat e projekteve tjera ose ngecjet e mundshme për periudhën që udhëheq këtë Ministri.

Ai dha sqarim, se secili komision kontakton me ministrinë përkatëse, dhe shtoi se edhe ministria e KK ka këshilltarë politikë por mungon bashkëpunimi me Komisionin.

Dragiša Mirić - diskutoi që të mos paragjykojmë por të kemi parasysh gjendjen shëndetësore të ministrit, andaj kërkoi që në takimin e ardhshëm të dëgjojmë ministrin lidhur me rezultatet e arritura gjatë mandatit të tij.

Rexhep Hoti – shtroi çështjen se rezoluta e miratuar nga OKB-ja i ka hapur dyert dialogut mes Beogradit dhe Prishtinës. Ai paraqet qëndrimin e tij që Komisioni të thërret ministrin e KK, i cili duhet të ofrojë raport me shkrim me propozime konkrete për bisedime. Më pas Komisioni do të caktojë një rend dite të cilin do ta paraqet në Kryesi dhe Kuvendi do të obligohet të hap debat, çka mund Qeveria të bisedoj në interes të dy shteteve.

Sanije Aliaj –ngriti çështjen e realizimit të planit të vlerësimit i cili del nga Raporti i Progresit. Në këtë kontekst mendon se Komisioni obligohet që përveç shqyrtimit të amandamentimit të projektligjeve të bëhet monitorimi i projekteve në Ministrit, si dhe monitorimi i kuvendeve Komunale, sa janë azhur në integritet të të drejtave dhe interesave të komuniteteve.

Duke u ndërlidhur me parafolësin z. Hoti, pajtohet që në takimin e radhës Komisioni të kërkojë nga ministri i KK, të paraqes projektin me shkrim në gjetjen e negociatave për bisedime.

Lidhur me këtë çështje ajo propozoi që Komisioni të organizojë tryezë të rrumbullakët dhe të ftohet MPMS, MASHT. Njëherit duhet realisht të zgjidhen të gjitha çështjet që vështirësojnë rrethanat r mirëfillta të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Republikën e Kosovës.

Lidhur me këto pika u pajtua Numan Balić dhe Xhevdet Neziraj.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Zëvendëskryetarja e parë Komisionit

Sanije Aliaj